



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 26 maj 2014  
Nr. ref.: RK635/14

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI05/13**

Parashtrues

**Florim Gashi**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 811/2006, të 14 marsit 2007**

### **GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Florim Gashi (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Klinë, i cili përfaqësohet nga z. Skënder Gashi.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston moszbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 811/2006, të 14 marsit 2007, nga Komuna e Klinës, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës në një datë të paspecifikuar.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit A. nr. 811/2006, të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 14 marsit 2007, me të cilin Gjykata Supreme, në procedurën administrative, e refuzoi ankesën e Komunës së Klinës. Procedura administrative ka të bëjë me aktvendimin e organeve komunale të Klinës për rrënimin e objektit, të përdorur nga parashtruesi i kërkesës për qëllime afariste.
4. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) “[...] që ta detyrojë Komunën e Klinës për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme”.

## **Baza juridike**

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 16 janar 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 30 janar 2013, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. KI05/13, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI05/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).
8. Më 28 shkurt 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme kopjen e kërkesës.
9. Më 7 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 14 mars 2005, në bazë të planit të ndryshuar urbanistik, Bordi i Drejtorëve i Komunës së Klinës nxori vendimin 1/3 NR. 353-247/2005, duke i revokuar të gjitha lejet ekzistuese për ndërtimin e objekteve të përkohshme në komunë. Bordi i Drejtorëve e justifikoi këtë vendim në bazë të pretendimit që të gjitha ndërtimet e përkohshme ekzistuese ishin ndërtuar në pronën që ishte në pronësi të Komunës, pronë kjo që Komunës i nevojitej për qëllime publike.

11. Ky vendim i Bordit të Drejtorëve, i 14 marsit 2005, kishte prekur edhe parashtruesin e kërkesës, i cili ishte duke e përdorur objektin për aktivitetet e tij afariste.
12. Rrjedhimisht, më 17 gusht 2005, Drejtoria për Urbanizëm dhe Shërbime Publike e Komunës së Klinës lëshoi Urdhrit nr. 07 nr. 354-122/2005 (në tekstin e mëtejme: Urdhri i Drejtorisë), duke e detyruar parashtruesin e kërkesës që ta rrënojë objektin.
13. Parashtruesit të kërkesës iu dhanë 15 ditë kohë për ta rrënuar objektin, ose Drejtoria do të vazhdonte me përmbarimin e dhunshëm të urdhrin të saj.
14. Pas kësaj, më 2 shtator 2005, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë te Kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Klinës kundër urdhrin të Komunës së Klinës.
15. Më 15 shtator 2005, Kryeshefi ekzekutiv i Klinës, me Aktvendimin 07 Nr. 354-122/2005 (në tekstin e mëtejme: aktvendimi i Kryeshefit ekzekutiv), hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi urdhrin e Drejtorisë.
16. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, më 14 tetor 2005, Drejtoria vazhdoi rrënimin e objektit.
17. Më 31 tetor 2005, kundër aktvendimit të kryeshefit ekzekutiv, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejme: MMPH).
18. Më 20 mars 2006, MMPH, me Vendimin e saj, A-106/05, e aprovoi ankesën e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, me të cilin anuloi aktvendimin e Kryeshefit ekzekutiv dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim.
19. MMPH-ja arsyetoi se Kryeshefi ekzekutiv në Klinë në aktvendimin e tij nuk e kishte konstatuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe nuk ua kishte kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave përkatëse ligjore për procedurë administrative, për shkak të të cilave u nxorën vendimet e padrejta. Rrjedhimisht, MMPH-ja vendosi:
 

*“Sipas nenit 242, al. 2 të Ligjit mi Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor [...] që lëndën ta kthejë në rishqyrtim. Organi i shkallës së parë është i detyruar të veprojë sipas vendimit të shkallës së dytë, jo më vonë se brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së këtij Vendimi dhe të nxjerrë Aktvendim të ri, duke i administruar provat e lartshënuara”.*
20. Komuna e Klinës paraqiti ankesë kundër vendimit të MMPH-së në Gjykatën Supreme. Në ankesën e saj, Komuna e Klinës pretendoi se aktvendimi i MMPH-së nuk ishte në pajtim me ligjin dhe se ligji ishte zbatuar në dëm të Komunës së Klinës.
21. Më 14 mars 2007, Gjykata Supreme e refuzoi ankesën e Komunës së Klinës.

22. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme konstatoi se:

*“Me vendimin e kontestuar është aprovuar ankesa e Florim Gashi nga Klinë dhe është anuluar aktvendimi i Kryeshefit ekzekutiv të Komunës së Klinës 07. nr. 354-122/2005 datë 15.09.2005 dhe lënda është kthyer në rishqyrtim.*

[...]

*“Gjykata konkludon se në këtë çështje juridike-administrative ekzistojnë kundërthënie të cilat nuk u evituan gjatë vendosjes nga ana e organit të shkallës së parë sepse nuk u morën parasysh provat në shkresat e lëndës dhe nuk u dhanë arsye për fakte vendimtare, të rëndësishme për vendosjen e drejtë të kësaj çështje juridike e konkretisht vërtetimi i faktit se a ekziston dhe a është aprovuar plani urbanistik për qytetin e Klinës, se është marrë vendimi nga Komuna e Klinës për revokimin e lejeve të përkohshme, se në rastin konkret a kemi të bëjmë me mënjanimin e objektit të përkohshëm apo rrënimin e dhunshëm të objektit i cili paraqitet në fazën e ekzekutimit të dhunshëm, çka nuk duhet të jetë situata në rastin konkret por edhe për faktin se nuk është konstatuar se ka kaluar apo jo afati i lejes sipas të cilës është bërë vendosja e objektit të përkohshëm*

*[...] Për këto arsye e me qëllim të evitimit të lëshimeve të theksuara në aktvendimin e kundërshtuar, organi administrativ i paditur anuloi vendimin e kundërshtuar duke dhënë udhëzime që në riprocedurë të evitohen të metat e me qëllim të marrjes së vendimit të drejtë dhe të ligjshëm”.*

23. Pas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Komuna e Klinës nuk ndërmori asnjë veprim në lidhje me parashtruesin e kërkesës.
24. Në bazë të parashtrësive, parashtruesi i kërkesës iu drejtua MMPH-së (letra e 17 prillit 2008) dhe Kuvendit Komunal të Klinës (letra e 21 prillit 2009) në lidhje me përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme.
25. Më 23 janar 2013, Komuna e Klinës kishte parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe anulimin e Aktgjykimit të lartpërmendur, A. nr. 811/2006, të Gjykatës Supreme dhe të 15 aktgjykimeve të tjera të Gjykatës Supreme. Komuna e Klinës më tej kërkoi anulimin e aktvendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor në të 16 rastet. Komuna e Klinës kishte paraqitur kërkesën e saj në bazë të nenit 113, paragrafi 4, të Kushtetutës (shih Rastin KO08/13, Gjykata Kushtetuese, Vendimi për papranueshmëri, i 29 nëntorit 2013).
26. Më 14 nëntor 2013, Gjykata, pas shqyrtimit, njëzëri vendosi ta deklarojë kërkesën të papranueshme, sepse Komuna e Klinës nuk ishte palë e autorizuar.

## **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

27. Parashtruesi i kërkesës argumenton se “[...] me këto vendime arbitrare, Komuna e Klinës ka bërë shkelje të rënda të dispozitave kushtetuese, duke ia pamundësuar [parashtruesit të kërkesës] sigurimin e mjeteve më elementare për ekzistencën e tij dhe familjes së tij 6 antarshe. Duke vepruar kështu Komuna e Klinës ka bërë shkelje të dispozitave kushtetuese mbi të drejtat dhe lirit e njeriut sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.”

28. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se ai i ishte drejtuar Komunës së Klinës me gojë dhe me shkrim për përmbarimin e aktgjykimit.

29. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës si në vijim:

*“Është relevante të theksohet se të gjitha procedurat e rregullta ligjore janë ndjekur në mënyrë të përpikt nga i dëmtuari [parashtruesi i kërkesës] deri te Gjykata Supreme e Kosovës, dhe pasi janë shterrur të gjitha mjetet juridike, jemi të detyruar që ti drejtohem Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës që ta vlerëson ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 811/2006 të 14.03.2007.”*

30. Parashtruesi i kërkesës përfundon, duke kërkuar nga Gjykata:

*“Përmes kërkesës tonë, kërkojmë prej Gjykatës Kushtetuese që ta detyroi Komunën e Klinës në zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke u mbështetur në nenin 116.1 sipas të cilit thuhet, se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Si dhe nenit 124.6 të obligohet Komuna që ta zbatoi Aktgjykimin e Republikës së Kosovës A. nr. 811/2006, si dhe Vendimin e Ministrisë së Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor Prishtinë Nr. A-106/2005 data 20.03/2006 i cili ka marrë formën e prerë në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës. [...]”*

## **Pranueshmëria e kërkesës**

31. Së pari, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

33. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

34. Siç u tha më lart, parashtruesi, në kërkesën e tij, konteston mospërmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 811/2006, të 14 marsit 2007, nga Komuna e Klinës dhe kërkon nga Gjykata "[...] që ta detyrojë Komunën e Klinës në zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme".
35. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në procedurën administrative, refuzoi si të pabazuar ankesën e Komunës së Klinës, të paraqitur kundër vendimit të MMPH-së. Sipas vendimit të MMPH-së, MMPH-ja kishte vendosur ta kthente rastin për rishqyrtim dhe kishte detyruar organin e shkallës së parë, përkatësisht Komunën e Klinës, që brenda 30 ditësh nga marrja e vendimit, të nxjerr vendim të ri bazuar në rekomandimin e MMPH-së. Për këtë arsye, pas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Komuna e Klinës ka qenë e obliguar të marrë një vendim të ri në lidhje me parashtruesin e kërkesës. Deri më tani, Komuna e Klinës nuk ka nxjerrë një vendim të tillë.
36. Duke pasur parasysh se procedura e ndjekur ka qenë procedurë administrative, Gjykata e konsideron të rëndësishme dhe të nevojshme t'i referohet dispozitave të Ligjit për konfliktet administrative.
37. Neni 29 i Ligjit për konfliktet administrative, Nr. 03/L-202, përcakton:
1. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa.
  2. Në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të veprojë pala edhe kur sipas kërkesës së saj nuk është nxjerrë vendimi nga organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit nuk mund të bëhet ankesa.
  3. Nëse organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit mund të bëhet ankesa, nuk ka nxjerrë asnjë vendim në bazë të kërkesës brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh ose në një afat më të shkurtër të paraparë me dispozita të veçanta, pala ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë organit të shkallës së dytë. Kundër vendimit të organit të shkallës së dytë, pala mund të fillojë konfliktin administrativ, por mundet, nën kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, ta fillojë edhe nëse ky organ nuk ka nxjerrë vendim.
38. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i është drejtuar MMPH-së (letra e 17 prillit 2008) dhe Kuvendit Komunal të Klinës (letra e 21 prillit 2009), vetëm duke kërkuar zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme.
39. Bazuar në si më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, pas skadimit të afatit të parashikuar me dispozitën e lartpërmendur të Ligjit për konfliktet administrative, duhej të kishte proceduar më tej me konfliktin administrativ dhe, në këtë mënyrë, do t'i shteronte mjetet juridike të parapara me ligj.

40. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi i kërkesës është i obliguar të shterojë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, siç parashihet me nenin 113, paragrafi 7, dhe me dispozitat e tjera ligjore, siç u përmend më lart. Prandaj, parashtruesi i kërkesës duhet të kishte paraqitur ankesë në organin e shkallës së dytë, pasi organi i shkallës së parë, Komuna e Klinës, nuk kishte arritur të merrte një vendim brenda afatit të paraparë.
41. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi përkitazi me kërkesën për shterim të mjeteve juridike është që t'u ofrohet mundësia autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive ligjore kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (Shih rastin *Selmouni kundër Francës*, GJEDNJ, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999; dhe rastin *KIO6/10*, parashtrues i kërkesës *Valon Bislimi*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykimi i 30 tetorit 2010).
42. Pra, në të vërtetë, duke mos proceduar me inicimin e konfliktit administrativ, pra duke mos ushtruar ankesë në organin e shkallës së dytë brenda afatit të paraparë, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës që rasti tij shpallet i papranueshëm, pasi që kjo do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedura të mëtejme për të kundërshtuar shkeljen e të drejtave kushtetuese (Shih rastin *KI16/12*, parashtrues *Gazmend Tahiraj*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri i 22 majit 2012).
43. Si përmbledhje, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 47, paragrafi 2, të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, më 7 maj 2014, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Ivan Čukalović



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani

